

Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2004/11, lidhur me Regjistrimin e Partive politike në Kosovë, Kuvendi Partisë Ekologjike të Kosovës, i mbajtur më _____2007 e miratua këtë

S T A T U T

Parimet themelore

Neni 1.

“Eko Levizja e Gjelbër“ (teksti i mëtejme:ELGj) është Parti politike e cila përmes Programit dhe Statutit i shpreh qëllimet e veta, duke i shfrytëzuar të gjitha metodat demokratike si dhe veprimet e lejuara me Ligj.

ELGJ-i për realizimin e qëllimeve të veta, bazohen në të gjitha shtresat e shoqërisë, të shoqatave dhe individëve, të cilët merren me mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit, ruajtjen, përrirjen dhe ndërprerjen e dëmtimit, degradimit dhe shkatërrimit të sajë.

ELGj-i ka për qëllim përmirësimin dhe përparimin e kualitetit jetësor të mjedisit të shëndoshë natyror, andaj, për këtë qëllim, angazhohet për ide dhe iniciativa të individuale dhe të përbashkëta, të barabarta në qasje dhe të përgjithshme, si dhe të bazuara në dialog demokratik, tolerancë dhe mirëkuptim pa dallime racore, nacionale, gjinore dhe pro llojllojshmërisë kulturore

Neni 2.

ELGj-i është person juridik dhe për obligimet e veta përgjigjet me tërë pasurinë vet. ELGj-i mund të realizojë të ardhura në përputhje me Ligjin e Partive Politike.

Emri, Selia dhe shenja

Neni 3.

Emri: “Eko Levizja e Gjelbër“

Shkurtesa: ELGJ

Selia: Prishtinë

Shenja: Forma katrore, si sipërfaqja e territorit të Kosovës, duket si gjethe, ngjyrë e gjelbër, në fund pamja e ujit me ngjyrë të kaltërt të çel, në anën e djathtë shkrimi “Eko Levizja e Gjelbër”. Akronimi “ ELGJ”

Vula: “Eko Levizja e Gjelbër“ e ka vulën e vet e cila e ka formë e katrorit, ngjyra e gjelber, në fund pamja e ujit me ngjyrë të kaltërt të çel, kudo të jetë shkrimi:Eko Levizja e Gjelbër.

Neni 4.

Për ndryshimin e Statutit, Programit, vendqëndrimit, vulës dhe emrit, vendos Kuvendi i ELGj-it. Propozimin për ndryshim dhe plotësim të Statutit dhe Programit politikë e paraqet Këshilli i përgjithshëm në bashkëpunim me Komisionin për çështje statusore.

Përfaqësimi

Neni 5.

ELGj-in e përfaqëson kryetari i partisë, ndërsa në mungesë të tij njeri prej nënkryetarëve të ELGj-it, të cilin e autorizon kryetari. Sekretari i Partisë mund të zëvendësojë kryetarin vetëm në kuadrin e kompetencave të fushveprimtarisë së tij administrative e juridike.

Anëtarësimi

Neni 6.

Anëtarë i ELGj-it mund të jetë çdo qytetar i Kosovës i moshës madhore i cili është i aftë për punë dhe që i kupton qëllimet dhe interesat e ELGj-it. Me rastin e aplikimit, anëtari bënë plotësimin e pyetësorit dhe nënshkrimin e tij.

Lartësia, përgatitja dhe mënyra e mbledhjes së anëtarësisë rregullohet me një akt të veçantë të afarizmit financiar, të cilin e nxjerr dhe e aprovon Kuvendi i ELGj-it.

Anëtarësimi bëhet duke u regjistruar në degë, sipas kriterit të vendbanimit të përhershëm të tij. Nëse nuk ekziston dega, anëtari sipas dëshirës së tij, anëtarësohet në njërin prej degëve të regjistruara.

Çdo anëtar merr Librezën e anëtarësisë.

Pamja dhe forma e librezës përcaktohet me Rregullore të veçantë,

Librin amzë të anëtarësisë e udhëheq Këshilli drejtues i degës, Këshilli drejtues i degës së Bashkësisë së qytetit apo komune si dhe Sekretari i përgjithshëm i ELGj-it.

Neni 7.

Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve:

Secili anëtar i ELGj-it ka të drejtë të marrë pjesë në degën e së cilës i takon dhe në të gjitha organet e sajë ku e angazhon aktivitetin e vet politik, veçanërisht në propozimin e aksioneve, diskutimeve dhe propozimeve konkrete, kërkesave për sqarim dhe informim dhe të votojë lidhur me to.

Është e drejtë statutare e secilit anëtar të jetë vazhdimisht, plotësisht dhe sinqerisht i informuar për punën dhe aktivitetin e të gjitha organeve të ELGj-it në të gjitha nivelet.

Secili anëtar i ELGj-it ka të drejtë të zgjedh dhe të zgjidhet në të gjitha organet e partisë, ndërsa është i obliguar në bazë të parimeve të Statutit të partisë, të i përfaqësojë dhe zbatojë interesat dhe politiken e partisë.

Anëtari i ELGj-it është i obliguar të angazhohet dhe të punojë me korrektësi dhe me përkushtim maksimal për zhvillimin, masivizimin, përkrahjen dhe interesin politik dhe real të ELGj-it dhe është i obliguar të kryej detyra të tjera të partisë.

Të kontribuoj në krijimin e strukturave të reja në parti, të bashkëveproj në masivizimin e partisë, propozimin dhe krijimin e organeve të ELGj-it.

Anëtari i ELGj-it nuk mund të jetë njëkohësisht edhe anëtar i ndonjë partie tjetër politike në Kosovë.

Neni 8.

Obligimet e udhëheqësve dhe përfaqësuesve të ELGj-it:

Udhëheqësit dhe përfaqësuesit e ELGj-it kanë të njëjtat detyra dhe obligime sikurse edhe anëtarët tjerë të partisë

Ata janë veçanërisht të obliguar të i përmbahen Statutit të partisë dhe të raportojnë për punën e vet dhe për të gjitha çështjet tjera politike nga fushëveprimi i kompetencave dhe

përgjegjësive të tyre, pran degëve së paku në çdo tremujor, ndërsa në nivelet më të larta, mvarsisht nga nevojat dhe kërkesat e udhëheqësis së partisë.

Neni 9.

Anëtarësia ndërpritet:

- nëse anëtari vdes,
- nëse anëtari tërhiqet, apo nëse vërtetohet ose vetë deklarohet se anëtari punon e vepron ne interes të një subjekti tjetër politik,
- nëse anëtari përjashtohet.

Anëtari ka të drejtë të del nga partia, duke paraqitur deklaratë me shkrim për dalje nga dega e partisë. Anëtari i partisë mund të përjashtohet, nëse bënë cenim të rëndë të obligimeve statutare. Vendimin për përjashtim e bien dega së cilës i takon, ndërsa për udhëheqës të partisë në të gjitha nivelet e bien Këshilli i përgjithshëm.

Neni 10.

Masat e përjashtimit ndërmerren në rast të shkeljeve të rënda të Statutit, të autoritetit të partisë apo anëtarëve të sajë

Me rastin e përjashtimit, paraprakisht zhvillohet procedura disiplinore nga ana e komisionit të përbërë prej tre anëtarëve, të cilin e cakton Këshilli i përgjithshëm.

Puna e komisionit disiplinor rregullohet me Rregullore të veçantë.

Në vendim për përjashtim, anëtari i përjashtuar mund të ushtroj ankesë Kuvendit të ELGj-it.

Struktura organizative

Neni 11.

Në qytete dhe komuna apo edhe vendbanime, mund të organizohen degët e ELGj-it.

Degët e ELGj-it mund të formohen në qytete dhe komuna apo vendbanime nëse kanë më shumë se dhjetë (10) anëtar.

Format e organizimit dhe numrin e nevojshëm për nëndegë dhe degë e cakton Këshilli i përgjithshëm në përputhje me Statutin e ELGj-it.

Neni 12.

Në Bashkinë e Qytete ku mund të ketë më shumë komuna, mund të formohen degët komunale sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë së qytetit.

E njëjta procedurë është edhe me rastin e themelimit të njësive të ELGj-it nëpër bashkësi lokale, lagje apo subjekte ekonomike, të cilat i themelon Këshilli i qytetit gjegjësisht Këshilli komunal i ELGj-it.

Neni 13.

Dega e ELGj-it në bashkinë e qyteteve apo komuna, mund ta iniciojë shpërndarjen e njësisë nga përbërja e sajë, nëse ajo vepron politikisht në kundërshtim me Programin dhe Statutin e ELGj-it.

Inicimi i shpërndarjes mund të i drejtohet Kryesisë së ELGj-it.

Lidhur me Vendimin e Kryesisë së ELGj-it, anëtari i pakënaqur, mund të i drejtohet Këshillit të përgjithshëm.

Neni 14.

Këshilli i përgjithshëm i ELGj-it me propozimin e Kryesisë së ELGj-it, mund ta shpërndaj degën e qytetit gjegjësisht të komunës sipas nenit 12 të Statutit, veçanërisht nëse me punën e vet i ka bërë dëm ELGj-it.

Kundër këtij vendimi, shpërndarja e Këshillit të qytetit apo ai i degës komunal mund të ushtrojë ankesë Kuvendit të ELGj-it..

Kryesia e ELGj-it e inicion procedurën për formimin e degës së re, në vend të asaj që është shpërndarë.

Neni 15.

Kryesia e ELGj-it mund të formoje degë edhe në shtetet të tjera- diasporë, ku jetojnë dhe punojnë qytetarët tanë.

Procedura rreth formimit të degës në shtetet e jashtme – diasporë është e njejt me atë në vend

Organet e ELGj-it

Neni 16.

Organet e ELGj-it janë:

- Kuvendi i ELGj-it,
- Kryetari,
- Këshilli i përgjithshëm,
- Kryesia,
- Sekretari i përgjithshëm,
- Këshilli mbikëqyrës.

Kuvendi i ELGj-it

Neni 17.

Kuvendi është organi më i lartë i ELGj-it.

Kuvendi i ELGj-it e përbëjnë delegatët e deleguar nga degët e komunave.

Kuvendin e kryeson Kryesia e Punës, e cila e zgjedh edhe kryesuesin.

Puna e Kuvendit rregullohet me Rregullore të cilën Kuvendi e miraton në fillim të punës së vet.

Kuvendi i ELGj-it duhet të mbahet më së paku në çdo 48 muaj.

Neni 18.

Mënyrën e zgjedhjes së delegatëve, numrin e delegatëve, kohën dhe vendin e mbajtjes së Kuvendit e përcakton Këshilli i përgjithshëm i ELGj-it.

Këshilli i përgjithshëm i ELGj-it i përgatit materialet e punës për Kuvend.

Thirrja e Kuvendit bëhet më së voni 30 ditë para mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit.

Së bashku me thirrje gjithsesi duhet të bashkëngjitet edhe materiali për punë të Kuvendit.

Neni 19.

Kuvendi i ELGj-it miraton Programin dhe Statutin, shqyrton Raportin e Këshillit të përgjithshëm të ELGj-it në mes të dy Kuvendeve, zgjedh Këshillin e përgjithshëm, Kryetarin, Nënkyetarët, Sekretarin e përgjithshëm.

Neni 20.

Kuvendi i jashtëzakonshëm mund të thirret:

- me Vendim të Këshillit të përgjithshëm,-me propozim të dy të tretave (2/3) të numrit të – me propozim të dy të tretave (2/3) të numrit të përgjithshëm të delegatëve.

Propozuesi duhet ta arsyetojë kërkesën për thirrjen e Kuvendit të jashtëzakonshëm. Kuvendin e jashtëzakonshëm e përbëjnë përfaqësuesit e zgjedhur të degëve, mandati i të cilëve zgjat deri në caktimin dhe mbajtjen e Kuvendit të rregullt të partisë.

Këshilli i përgjithshëm i ELGj-it

Neni 21.

Këshilli i përgjithshëm është organi më i lartë i ELGj-it për periudhën në mes të dy Kuvendeve.

Numri i anëtarëve të Këshillit të përgjithshëm caktohet në secilin Kuvend për një mandate dyvjeçar.

Mbledhjen e Këshillit të përgjithshëm, përveç kryetarit, mund ta thërras edhe shumica e anëtarëve të këtij organi të partisë

Neni 22.

Këshilli i përgjithshëm i ELGj-it:

- miraton dokumente dhe Rregulloren për punën e vet,
- përcakton politiken e ELGj-it në harmoni me vendimet e Kuvendit për periudhën në mes të dy mbledhjeve të Kuvendit,
- miraton Programin zgjedhor të ELGj-it,
- bënë plotësimin e Këshillit të përgjithshëm me kooptimin e njëtëtrtës së Këshillit, në raste kur ndonjë prej anëtarëve të Këshillit të përgjithshëm iu është ndërpre statusi i anëtarit në parti,
- miraton vendime lidhur me financimin e ELGj-it dhe formimin e shoqatës dhe agjencisë, me propozimin e Kryesisë së ELGj-it
- emëron udhëheqësit e shoqatës apo agjencisë, sipas propozimit të Kryesisë së ELGj-it
- emëron anëtarët e Komisionit disiplinor,
- vendos lidhur me ankesat mbi shpërndarjen e njësive dhe përjashtimin e anëtarëve nga partia.
- bënë zgjedhjen e Komisionit për çështje statutare të ELGj-it

Neni 23.

Këshilli i përgjithshëm financohet nga mjetet e anëtarësisë si dhe nga donacionet e degëve komunale, në bazë të Planit financiar të cilin e aprovon Kuvendi i ELGj-it.

KRYETARI I ELGJ- ut

Neni 24.

Kryetarin e ELGj-it e zgjedh dhe e shkarkon Kuvendi i ELGj-it për mandat katërvjeçar, I njëjti mund të zgjidhet edhe në mandate të tjera.

Kryetari i ELGj-it sipas funksionit është njëkohësisht kryetar i këshillit të përgjithshëm.

Neni 25.

Kryetari i kryen këto punë dhe detyra:

- Zbaton politiken e ELGj-it
- Thërret Kuvendin e ELGj-it
- E përfaqëson partin në vend dhe jashtë vendit.
- Nënshkruan dhe lidh kontrata në emër dhe llogari të ELGj-it,
- Nënshkruan urdhëresa për pagesa të cilat kryen nga mjetet e ELGj-it,
- Nënshkruan dokumentet e ELGj-it apo e cakton zëvendësin,
- Propozon emërimin dhe shkarkimin e nënkryetarëve të ELGj-it
- Propozon emërimin dhe e shkarkimin e sekretarit të ELGj-i
- Thërret mbledhjen e këshillit të përgjithshëm të ELGj-it dhe udhëheq mbledhjen,
- I propozon kandidatet për anëtar të kryesisë së ELGj-it,
- zgjedh përfaqësuesit e partisë për pjesëmarrje në takime ndërkombëtare,
- Koordinon punën e ELGj-it dhe përpiqet për realizimin e qëllimeve në përputhje me programin e ELGj-it.
- Për punën e vet i përgjigjet kuvendit të ELGj-it.

Neni 26.

Procedura për verifikimin e besueshmërisë së kryetarit të ELGj-it mund të iniciohet në bazë të iniciativës të dy të tretave të degëve apo dy të tretat të anëtareve të këshillit të përgjithshëm si dhe në baze të iniciativës së tij.

Në rast se kryetari nuk i epet besimi mund të thirret kuvendi i jashtëzakonshëm i ELGj-it.

Në rast se kryetari tërhiqet vet këshilli i përgjithshëm deri mbajtjen e Kuvendi të ardhshëm, emëron ushtruesin e detyrës së kryetarit të ELGj-it.

Nënkryetari i ELGj-it

Neni 27.

Nënkryetar i ELGj-it ka këto detyra:

- zëvendëson kryetarin për kompetencat për të cilat ai e autorizon **me shkrim**.
- përcjell dhe koordinon punën e ELGj-it në koordinim dhe marrëveshje me kryetarin,
- nënkryetari për punën e vet i përgjigjet kryetarit dhe organeve të ELGj-it.

Neni 28.

Këshilli i përgjithshëm mund të i zgjedh shumë nënkryetar, për koordinim të drejtpërsëdrejti me punën e ELGj-it në regjione.

Sipas detyrave, resorëve si dhe vëllimit të punëve konkrete numri i nënkryetarëve mund të rritet apo edhe të zvogëlohet.

Neni 29.

Emërimi dhe shkarkimi i nënkryetarit bëhet në të njëjtën mënyrë sikurse edhe te kryetari. Propozimin për shkarkimin e tij mund ta inicioj edhe kryetari i ELGj-it.

Sekretari i përgjithshëm i ELGj-it

Neni 30.

Sekretari i përgjithshëm i ELGj-it udhëheq me punët tekniko-administrative si dhe për punët juridike e përfaqëson ELGj-in.

Sekretari i përgjithshëm udhëheq edhe me sekretarinë e ELGj-it

Kryesia e Partisë

Neni 31.

Kryesinë e partisë e përbëjnë:

- Kryetari i partisë
- **Tre** nënkryetar të partisë,
- Nënkryetari i këshillit të përgjithshëm,
- Sekretari i përgjithshëm i partisë,
- Kryetari i këshillit mbikëqyrës.

Kryesia takohet me ftesën e Kryetarit të partisë, sipas nevojës, dhe bien vendime operative që dalin nga Statuti dhe Programi i saj. Personi i autorizuar për udhëheqjen e financave dhe punët të kontabilitetit sipas funksionit të cilin e mban është anëtar i kryesisë së partisë.

Kryesia vendos mbi çështjet aktuale politike, vendos dhe shkarkon komisionet e përkohshme të partisë, personin i cili kryen punët e kontabilitetit, redaktorët e revistës partiake, vendos për ankesa në shkallen e parë, për shpërndarjen e organeve në njësi më të ultë organizative, verifikon rregulloret, urdhëresat dhe udhëzimet.

Kryesia ne mbledhjet e veta mund të i ftojë edhe anëtarë të tjerë të partisë si dhe persona të cilët kryejnë funksione të caktuara, si dhe ekspertet e fushave të ndryshme, por pa të drejtë vote.

Kryesia e partisë mund të ketë 11 deri 15 anëtarë.

Kryesia e ELGj-it sipas rrethanave, nevojave dhe strukturave të partisë, mund të kooptojë numër të caktuar anëtarësh, personalitetë të fushave të ndryshme.

Sekretaria e ELGj-it

Neni 32.

Sekretaria e ELGj-it është organ ekzekutiv i Kuvendit të partisë, të kryetarit të partisë, të kryesisë dhe Këshillit të përgjithshëm, e cila në kuadrin e autorizime **statutore** kryen punët tekniko-operative të kuptimit administrativë.

Në krye të sekretarisë gjendet sekretari i përgjithshëm i ELGj-it, person i cili mund të jetë i angazhuar si profesionist sipas natyrës së punëve të cilat i kryen, dhe me të cilin mund të themelohet edhe marrëdhënia e punës në kohë të caktuar apo të pacaktuar.

Sekretari i përgjithshëm organizon punën e sekretarisë së partisë, në konsultim me kryetarin, zgjedh dhe shkarkon nëpunësit e sekretarisë, cakton vëllimin e punëve vullnetare të aktivitetit të anëtarëve të ELGj-it, ndihmon në punën e organeve më të ultë organizativ, koordinon punën në zbatimin e vendimeve të ELGj-it me degët tjera në parti, kujdeset për informimin brenda për brenda partisë dhe organeve të sajë, bënë azhurimin dhe mban evidencën për anëtarë, për miratimin e vendimeve, për emërimin e personave të cilët mbajnë funksione udhëheqëse në organet e ELGj-it, përgatit propozim vendimet në shkallën e parë dhe të dytë mbi udhëzimet juridike.

Komisioni për qështje statutare

Neni 33.

- Komisioni për qështje statutar ka tre anëtar,
- Anëtarët e Komisionit Statuar i zgjedh Kuvendi i ELGj-it
- Mbledhja konstituive të Komisionit statutar duhet thirret më së voni 30 ditë pas mbajtjes së Kuvendit të ELGj-it, në të cilën mbledhje duhet zgjedhur edhe kryetari i komisionit statutar,
- Komisioni Statuar i ELGj-it nxjerr edhe Rregulloren për punën e vet,
- Komisioni statutar drejtpërsëdrejti i përgjigjet Kuvendit të ELGj-it,
- Komisioni Statuar i ELGj-it paraqet Raport mbi punën e ELGj-it.,
- Anëtarët e Komisionit Statuar njëkohësisht nuk mund të jenë anëtar të Këshillit të përgjithshëm, të Kryesisë, apo të Këshillit mbikëqyrës të ELGj-it,

Neni 34.

Komisioni Statuar i kryen këto aktivitete partiake:

- Bënë vlerësimin statutar të akteve të përgjithshme dhe të akteve të tjera të ELGj-it,
- Merr në kompetencat e veta punën e komisioneve statutare të degëve të ELGj-it, nëse për te janë plotësuar kushtet e parapara me Statut.
- Propozon plotësimin dhe ndryshimin e Statutit,
- Përcjell zbatimin e Statutit,
- Ofron komente në Statut,
- E lajmëron Këshillin e përgjithshëm dhe Kuvendin për shkelje në Statut,
- Ofron ndihmë në përpilimin e Vendimeve të bazuara në Statut për degët dhe anëtarë të ELGj-it.
- Bien vendimin përfundimtar për përjashtim nga anëtarësia e ELGj-it,

Këshilli Mbikëqyrës i Partisë

Neni 35.

Këshilli mbikëqyrës i Partisë ekologjike të Kosovës është definuar në formën e Organit mbikëqyrës në të gjitha nivelet organizative. Organet mbikëqyrëse kanë obligime dhe autorizime të mbikëqyrin punën financiare-materiale dhe punët të tjera të ELGj-it dhe për te sipas nevojës, por për secilin vit kalendarik, të paraqes raport me shkrim Kuvendit të ELGj-it.

Këshilli mbikëqyrës i ELGj-it përbëhet prej pesë anëtarëve, të cilët zgjidhen në Kuvendin e përgjithshëm të ELGj-it, ndërsa anëtarët e këshillave mbikëqyrës të degëve zgjidhen në kuvendet e tyre.

Të rinjtë e ELGj-it

Neni 36.

Për anëtar të rinj të ELGj-it mund të jetë individ i cili i ka 14-18 vjet. Ata mund të marrin pjesë në mbledhjet e ELGj-it, të marrin pjesë në punën e Kuvendit të ELGj-it, si dhe të japin propozime, por nuk kanë të drejtë vote.

Neni 37.

Përfaqësuesi i të rinjve të ELGj-it, me Vendimin e Kuvendit të ELGj-it, bëhet anëtar i Këshillit të përgjithshëm të ELGj-it, me të drejtë vote, po sa të ketë mbushur 18 vjet.

Degët e ELGj-it dhe organet e tyre

neni 38.

Degët e ELGj-it, i kanë këto organe:

1. Kuvendi,
2. Kryetarin,
3. Këshillin e degës komunale,
4. Sekretarin,
5. Këshillin mbikëqyrës.

Degët kanë edhe njësite e saja.

Kuvendet e degëve

Neni 39.

Kuvendi është organi më i lart i Degës komunale të ELGj-it dhe e përbëjnë të gjithë ata anëtar të cilët janë

të regjistruar në degë. Kuvendin e udhëheq kryetari i degës.

Kuvendi mbahet më së paku njëherë në dy vite dhe punon në bazë të Rregullores së punës, të cilën e miratohet në fillim të mbledhjes së Kuvendit.

Procedura e mbajtjes së Kuvendit, zgjedhjes së kryetarit dhe organeve të tjera të degëve të partisë bëhet në të njëjtën mënyrë si dhe të zgjedhja e tyre në organet qendrore.

Neni 40.

Kuvendi i degës së ELGj-it ka këto kompetenca:

- miraton Rregulloren për punën e vet,
- nxjerr Statutin e degës,
- miraton Programin e punës së degës,
- përcakton numrin, zgjedh kryetarin dhe nënkryetarin si dhe anëtarët e Këshillit të degës komunale të ELGj-it, dhe anëtarët e Këshillit mbikëqyrës,
- shqyrton raportin mbi punën e Këshillit të degës komunale ndërmjet dy Kuvendeve,
- shqyrton raportin e Këshillit mbikëqyrës,
- përcakton politiken e degës në nivelin lokal, e cila është në harmoni me politiken kryesore, qëndrimet dhe përcaktimet e ELGj-it,
- zgjedh delegat për Kuvendin e ELGj-it,
- shqyrton edhe çështje të tjera sipas urdhrave të Këshillit të përgjithshëm, gjegjësisht kryesisë së ELGj-it.

Këshilli i degës komunale

Neni 41.

Këshilli i degës komunale, është organ ekzekutiv i Kuvendit të degës së ELGj-it, i cili organizohet nëpërmjet këshillave dhe komisioneve.

Këta këshilla i kryejnë këto aktivitete dhe detyra:

- udhëheq me punën e degës në komunë gjegjësisht qytet.
- organizon aktivitetet vijuese në nivelin komunal,
- e zgjedh sekretarin e këshillit të degës së ELGj-it,

- zgjedh kandidat për delegat në kuvendin e degës komunale dhe propozon kandidat për Këshillin e përgjithshëm,
- udhëheq me fushatën zgjedhore në nivelin lokal,
- kryen edhe punë dhe detyra të tjera me qëllim të masivizimit dhe forcimit të ELGj-it.

Për punën e vet Dega komunale, i përgjigjet Këshillit të përgjithshëm të ELGj-it dhe kryetarit të saj.

Neni 42.

Me Degën komunale gjegjësisht të baskisë së qytetit udhëheq kryetari i degës, të cilin e zgjedh Kuvendi i degës i cili duhet ta ketë edhe zëvendësin, një apo më shumë, sipas nevojës.

Për punën e tije kryetari i Këshillit të degës i përgjigjet Kuvendit të degës dhe Këshillit të përgjithshëm të ELGj-it.

Neni 43.

Sekretari i Këshillit të degës komunale të ELGj-it, kryen këto punë dhe detyra tekniko-administrative,

- e përgatit mbledhjen e këshillit të komunës,
- nënshkruan dokument për të cilët e autorizon kryetari i këshillit
- kujdeset për arkëtimin dhe mbledhjen e anëtarësisë dhe mjete për punë të organit,
- i kryen edhe punët teknike rreth regjistrimit të anëtarëve të rinj.

Kryen edhe punë dhe detyra të tjera për të cilat e angazhon kryetari i këshillit komunal gjegjësisht të qytetit.

Këshilli mbikëqyrës i degës

Neni 44.

Këshilli mbikëqyrës i degës, gjegjësisht i këshillit të degës të ELGj-it është organ i pavarur i Kuvendit të degës.

Mënyra e zgjedhjes, numrin e anëtarëve dhe fushëveprimi i Këshillit mbikëqyrës është identik me nenin 32. të Statutit e ELGj-it.

Njësitë organizative të ELGj-it

Neni 45.

Njësia e ELGj-it është forma themelore e organizimit të ELGj-it. Themelohet me vendimin e Këshillit komunal gjegjësisht të qytetit të degës së ELGj-it për bashkësi lokale, gjegjësisht lagje apo subjekte – persona të tjerë juridik.

Njësia i mban mbledhjet e veta, ndërsa puna e sajë është e rregulluar me Vendim statusor të cilin e nxjerr këshilli komunal gjegjësisht i qytetit të degës së ELGj-it.

Neni 46.

Me Vendim definohet bashkësia lokale, gjegjësisht lagja apo subjekti tjetër juridik në të cilën themelohet njësia, emërohet koordinatori i cili udhëheq me punën e njësisë, emëron arkëtarin i cili e bënë arkëtimin e anëtarësisë së anëtarëve të ELGj-it nga lokaliteti të cilin e përfshin njësia dhe më për së afërmi përcakton detyrat dhe qëllimet e njësisë si që janë:

- puna në masivizimin dhe regjistrimin e anëtarëve të rinj të ELGj-it,
- afirmimin dhe popullarizimin e ideve dhe programin e ELGj-it në mesin e popullatës së lokalitetit,
- përcaktimin e prioritetëve për vendosjen e problemeve komunale të njësisë.

Neni 47.

Koordinatori i njësisë për punën e vet i përgjigjet Këshillit komunal gjegjësisht atij të qytetit të degës së ELGj-it, dhe është i pavarur në zgjedhjen e bashkëpunëtorëve të vet me të cilët i realizon aktivitetet e njësisë.

Vendimmarrje

Neni 48.

Për mendimet dhe qëndrimet e veta të lira, kreative, të argumentuara dhe konstruktive, anëtari i ELGj-it nuk mban përgjegjësi.

Vendimet dhe konkluzionet e miratuara, me shumicë votash, nga organet kompetente-forumet partiake, janë obliguese për zbatim nga secili organ dhe anëtar i ELGj-it.

Neni 49.

Vendimmarrja në të gjitha nivelet e ELGj-it bëhet me procedurë demokratike me shumicë votash, nëse me Statut nuk është rregullua ndryshe.

Zgjedhjet e ELGj-it

Neni 50.

Zgjedhjet e ELGj-it bëhen çdo dy vite.

Zgjedhjet sipas rregullit bëhen me vota të mbëshefta, ose në rast se dy të tretat e të pranishmëve në cilin do tubim të ELGj-it deklarohen për vota të hapura, mund të votohet edhe në atë mënyrë.

Neni 51.

Secili anëtar i ELGj-it mund të propozojë kandidat dhe të jetë i propozuar për funksione në organet brenda partisë.

Këshilli i përgjithshëm i ELGj-it jep mendim dhe vlerësim për kandidat të cilët rekomandohet që të jenë pjesëmarrës në zgjedhjet lokale apo qendrore, për funksione publike, organe ekzekutive apo për deputet.

Pjesëmarrja në zgjedhje

Neni 52.

Vendimin për pjesëmarrjen të ELGj-it, dhe të anëtarëve të sajë në zgjedhjet qendrore dhe lokale si dhe për bartësit e funksioneve ekzekutive e publike e nxjerr Këshilli i përgjithshëm i ELGj-it.

Vendimin për zgjedhje për Kuvendet e qeverive lokale-komunale e nxjerrin Këshillat komunale, gjegjësisht të bashkisë së qytetit të degëve nga territori në të cilin bëhen zgjedhjet lokale.

Vendimin për pjesëmarrje të anëtarëve të ELGj-it për pjesëmarrje në organet qendrore dhe të Parlamentit të Kosovës në të gjitha nivelet e nxjerr Këshilli i përgjithshëm për të

pamundësuar manipulimin në pjesëmarrjen e tyre në seancat e kuvendit me qëllim të plotësimit të kuorumit.

Neni 53.

Vendimin për hyrjen e ELGj-it në ndonjë koalicion, parazgjedhor ose pas zgjedhor, bashkim me subjektet dhe partitë tjera politike si dhe daljen e sajë nga koalicionet të tilla e nxjerr Këshilli i përgjithshëm, me propozimin e Kryesisë së ELGj-it.

Neni 54.

Secili kandidat në listat zgjedhor të ELGj-it është i detyruar që me shkrim të obligohet se do të ofroj dorëheqje nga funksioni i këshilltarit, delegatit si dhe funksione të tjera, nëse për çfarëdo arsyeje i ndërpritet statusi i anëtarit të ELGj-it, apo një gjë të tillë, nga ai, e kërkon Këshilli i përgjithshëm i ELGj-it, për shkak të mos resELGjtimit të programit dhe politikës së ELGj-it.

Neni 55.

Grupet e deputetëve dhe të këshilltarëve, të cilët duhet organizuar “Eko Levizja e Gjelbër” në kuvendet në të cilët janë deputet të zgjedhur, gjegjësisht këshilltarë të ELGj-it, do të rregullohet me Rregullore të veçantë nga Këshilli i përgjithshëm i ELGj-it.

Neni 56.

Deputeti, gjegjësisht këshilltari i ELGj-it, në mesin ku nuk ekziston grupi i deputetëve apo i këshilltarëve, mund të i bashkëngjitet ndonjë grupi deputetësh apo këshilltarësh, i cili ka program të ngjashëm, me pëlqimin e degës së qytetit, gjegjësisht të komunës së ELGj-it, nëse ka të bëjë me qeverisjen lokale, ndërsa për nivele më të larta me pëlqimin e Këshillit të përgjithshëm.

Veprimtaria e ELGj-it

Neni 57.

Përveç veprimtarisë politike të ELGj-it, Këshilli i përgjithshëm, Kryesia, Këshillat e komunave gjegjësisht qyteteve të degëve, munden që me qëllim të realizimit të objektivave dhe detyrave të ELGj-it, të organizojnë:

- marketing politik,
- veprimtari botuese,
- veprimtari propaganduese,
- veprimtari edukative, konsalting dhe projektim, lidhur me mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor, në përmirësimin e kushteve të punës dhe inovacioneve teknologjike, veçanërisht në lëmin e ndërrimit të teknologjive të vjetruara dhe ndotëse, për ushqim, ujë dhe ambient të shëndosh.

Këto veprimtari si dhe aktivitetet të tjera ekonomike mund të jen të organizuara në formë të shoqatës apo agjencisë, në përbërje të ELGj-it apo me organizimin të drejtë për së drejtë ose nga njëra prej strukturave organizative nga pika një i këtij neni.

Financimi dhe prona e ELGj-it.

Neni 58

ELGj-i financohen nga anëtarësia, donacionet, sponsorët,(jo nga veprimtarite te tjera) ,nga buxheti i destinuar për financimin e partive politike, dhuratave, trashëgimive etj.

Neni 59.

Në raste shuarje të ndonjë dege të ELGj-it, pasuria e saj i mbetet Partisë Ekologjike të Kosovës.

Ndërprerja e veprimtarisë së ELGj-it bëhet në mënyrën se si është parapa me Ligj.

ELGj-i mund ta ndërpres veprimtarinë e vet nëse për te kanë vendos të gjithë anëtarët e ELGj-it,

Nëse ELGj-i posedon me ndonjë pasuri, ajo me rastin e ndërprerjes së veprimtarisë së vet, do të ndahet sipas Vendimit të Kuvendit të ELGj-it, sipas Vendimit të Këshillit të përgjithshëm ose sipas Vendimit të Gjykatës kompetente.

Dispozitat përfundimtare

Neni 60.

Çdo anëtar i ELGj-it ka të drejt të inicioj dhe të propozoj ndryshimin dhe plotësimin e pjesërishtë apo të tërësishëm të Statutit.

Propozimin e paraqitur e shqyrton Komisioni për çështje statusore dhe lidhur me qëndrimet e marruara, e njofton Kuvendin vijues të ELGj-it.

Procedura e aprovimit të ndryshimit dhe plotësimit të Statutit është identik me procedurën e nxjerrjes së Statuti.

Neni 61.

Ky statut bëhet i plotfuqishëm ditën kur i njëjti do të miratohet në Kuvendin e ELGj-it. Statutin e miratuar e nënshkruan kryetari i ELGj-it.

Partia e Ekologjike e Kosovës.

Prishtinë, 10.02.2018

K r y e t a r i ,
Mr.sc. Arif Krasniqi,